



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 20.10.2021

NR.09/ 8338 /2021

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-21-6817-1-4-7/C217 & KKHE (VM)-21-030-147

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilin e perfa qeson Xhevdet Bushi si shef i zyrës së prokurimit në njërën anë; dhe

ELEKTRA L.L.C., rr.Adem Jashari, Hani i Elezit, me NUL.811481887,(në vazhdim "Furnizuesi"),te cilin e perfaqeson Halide Rexhallari perfaqesuese me autorizim me nr. te ID-së 1176472134 leshuar nga MPB- Republika e Kosovës në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Zerimi i salles se sportive ne SHFMU. Ilaz Thaçi - Hani i Elezit me numër identifikues: 659-21-6817-1-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Zerimi i salles se sportive ne SHFMU. Ilaz Thaçi - Hani i Elezit

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Salla e sportive tek SHFMU."Ilaz Thaçi"-Hani i Elezit

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 986.00 €; [Nëntëqindë e tetëdhjetë e gjashtë euro e zero zero centi] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Nderkombetare

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalë "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	20.10.2021
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Halide Rexhallari
Pozita:	Perfaqësues me autorizim
Nënshkrimi:	
Data:	20.10.2021
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-21-6817-1-4-7/C217

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Neni</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe ..
Siguria e ekzekutimit	9.1	N/A
Sigurimi	10.1	Fletgarancion per 12 muaj nga OE-Nga momenti i pranimit te furnizimie
Programi i ekzekutimit	11	<i>Kohëzgjatja e kontrates eshte tridhjet (30) dite nga koha e nenshrkimit te saj</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>Te gjitha tatime dhe taksat tjera mbulohen nga OE-deri ne realizimin e furnizimit montimit dhe leshimit ne funksion te tyre</i>
Patentat dhe licencat	13.1	<i>[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]</i>
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>AK-Ka te drejt te kontrollon cilësin dhe sasin e furnizimit ne moment kur behet edhe furnizimie dhe montimi nga OE</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Paisjet do te kontrollone ne cilesi dhe sasi dhe me pas do te pranohennga AK-</i>
Pagesa	20.1	<i>[Pagesa do te behet pas pranimit te Furnizimit ne cilesi dhe sasi te pranueshme per AK-dhe pas pranim te fatures se nga OE-. Pagesa do te behet brenda afati ligjor</i>
Dorëzimi	21.3	<i>Paisje do te jene te reja te papderorura edhe ashtu siq kerkohen ne dosje te tenderit</i>
Obligimet e garancionit	24.1	<i>Paisjet e furnizuara duht te kene garancion minumum12 muaj nga koha e furnizimie te tyre nga OE-te siguruar me fletgarancion nga OE.</i>
	24.5	<i>[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Fletgarancion per 12 muaj nga OE-Nga momenti i pranimit te furnizimie dhe montimit te tyre</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>[Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[[Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti per çeshtje ekonomike]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>